

Annual review of

# TERRITORIAL GOVERNANCE IN ALBANIA

## QEVERISJA TERRITORIALE NË SHQIPËRI

Regional Development: policy  
and financing mechanism

Spatial Planning and Land  
Development

European Spatial Integration of  
Western Balkans

Decentralization: local finances  
and the post territorial reform

Sustainability: Climate, Energy,  
Tourism

Cohesion Policy and Urban  
Dimension

Annual Review of

**TERRITORIAL**

**GOVERNANCE** IN ALBANIA

---

QEVERISJA TERRITORIALE NË SHQIPËRI

---

## Annual Review of Territorial Governance in Albania

Qeverisja Territoriale në Shqipëri

Issue | Numri 1 November | Nëntor 2018

Print ISSN 2617-7692

Web ISSN 2617-7684

### Editor-in-Chief | Kryeredaktor

Dr. Rudina Toto

### Editorial Board | Këshilli Redaksional

Prof. Besnik Aliaj

Dr. Dritan Shutina

Dr. Sotir Dhamo

Dr. Peter Nientied

Dr. Marjan Nikolov

Prof. Sherif Lushaj

### Language Editors | Redaktor letrar

Olta Çakçiri (Shqip)

Maren Larsen (English)

### Design | Përpunimi grafik

Ada Lushi

Dorjan Elezaj

Aida Ciro

Lorena Gjana

Arba Bekteshi

**Scope:** *Annual Review for Territorial Governance in Albania* is a periodical publication with select policy briefs on matters related to territorial governance, sketching the present situation, the Europeanisation process, the policy, and the research and development agenda for the near future. The publication will be in both languages, English and Albanian, and it will target policy-makers and policy-influencing actors.

**Qëllimi:** Periodiku *Qeverisja Territoriale në Shqipëri* botohet një herë në vit. Artikujt e këtij periodiku bazohen në punë kërkimore shkencore dhe vlerësime ekspertësh. Artikujt synojnë të prodhojnë njohuri që ndikon formësimin e politikave publike në Shqipëri në lidhje me qeverisjen territoriale dhe marrëdhënien e saj me procesin e Europianizimit. Publikimi i periodikut kryhet në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht, njëkohësisht.

**Copyright @ 2018 Co-PLAN, Institute for Habitat Development and POLIS Press.** All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored, transmitted, or disseminated, in any form, or by any means, without prior written permission from the Publishers, to whom all requests to reproduce copyright material should be directed, in writing. | Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, transmetohet, apo shpërndahet, pavarësisht mënyrave të përdorura, pa lejen paraprake me shkrim nga Publikuesit. Kërkesa për riprodhim të materialit/materialeve duhet t`i drejtohet Publikuesve me shkrim.

Publishers November 2018 | Nëntor 2018



## Table of Contents | Tabela e përmbajtjes

---

<b>Editorial</b>	<b>6</b>
<b>Challenges of Regional Development in Albania   Sfidat dhe rruga drejt zhvillimit rajonal në Shqipëri</b> Fiona Imami, Anila Bejko (Gjika), Dritan Shutina	<b>8</b>
<b>Albania: Towards a More Effective Financing Mechanism for Regional Development   Drejt një mekanizmi më efektiv për financimin e zhvillimit rajonal në Shqipëri</b> Kejt Dhrami, Anila Bejko (Gjika)	<b>24</b>
<b>Europeanisation of Spatial Planning in Albania   Evropianizimi i planifikimit të territorit në Shqipëri</b> Ledio Allkja	<b>38</b>
<b>Land Development in Albania – Challenges and Innovations   Zhvillimi i tokës në Shqipëri – sfida dhe inovacion</b> Rudina Toto, Ledio Allkja	<b>55</b>
<b>Territorial Administrative Reform and the Decentralization Strategy – Progress towards the Desired Objectives after a Governing Mandate   Reforma administrative-territoriale dhe strategjia e decentralizimit – Sa pranë/larg objektivave të dëshiruar jemi pas një mandati qeverisës?</b> Merita Toska, Anila Bejko (Gjika)	<b>69</b>
<b>Sustainable Tourism Development in Albania   Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri</b> Aida Ciro, Merita Toska	<b>84</b>
<b>Is ETIS a Viable Option for Fostering Sustainable Tourism?   A është ETIS një opsion i realizueshëm për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm?</b> Peter Nientied, Dritan Shutina	<b>94</b>
<b>Governance for Climate Change Resolution   Qeverisja për zgjidhjen e problematikave që lidhen me ndryshimet klimatike</b> Rodion Gjoka, Xhesika Hoxha, Kristi Bashmili	<b>105</b>
<b>Energy Sector Towards the Renewable Potential in the Albanian Context   Sektori i energjisë dhe BRE në kontekstin shqiptar</b> Rodion Gjoka	<b>122</b>
<b>Territorial Governance Challenges of the Western Balkans in Europe   Sfidat e qeverisjes territoriale të Ballkanit Perëndimor në rrugëtimin drejt Evropës</b> Co-PLAN, Institute for Habitat Development   Instituti për Zhvillimin e Habitatit	<b>143</b>
<b>European Spatial Integration: The Western Balkans Discontinuity   Integrimi hapësinor i Evropës: mosvijmësia e Ballkanit Perëndimor</b> Giancarlo Cotella	<b>156</b>
<b>The Urban Dimension of the EU Cohesion Policy and Beyond   Dimensionimi urban i Politikës së Kohezionit të BE-së dhe më tej</b> Iván Tosics	<b>167</b>

# EDITORIAL

---

In view of current socio-political ambitions and regional dynamics in Albania as part of the Western Balkans, Co-PLAN, Institute for Habitat Development and POLIS University, introduce the first issue of the *'Annual Review of Territorial Governance in Albania'*. This is a platform aimed at furthering the research on territorial governance on a domestic and regional level, bringing together research and policy-influencing actors from the Western Balkan countries.

This annual publication is dedicated to the territory, given its intrinsic relation to resources, development, and consequently governance. The articles focus mostly on territorial or place-sensitive governance in Albania, but provide analyses and insights on the connections between national territorial frameworks and policies, and those in the European Union and in the Western Balkans, to enhance the domestic territorial governance (TG) and impact in a 'unique voice' the EU integration of the Western Balkan countries from a TG perspective.

We focus on territorial governance precisely for its place-sensitive dimension. This is governance that cares for the territory and resources, regardless of administrative boundaries and political representations, and as such, it ought to be implemented in each sector considering that all sectors are resource-dependent. Whilst planning is an important domain that emphasises the role of the territory in policy-making, it is only one form of territorial governance. The success of the latter depends on the coordination it manages to achieve with other development sectors, and on the synergies among sectors. This implies dynamic interactions among stakeholders (formal and informal) at any institutional levels and territorial scales. Therefore, the articles, as you will find, deal with a number of sectors and their interrelation to the territory, and the various multi-level, polycentric forms of governance.

Each article is a policy brief that makes use of research, information, and analysis carried out by the authors, and provides policy recommendations mostly to domestic institutions, while also contributing to reducing the information gap on Albania at an international scale. We remain hopeful that such analyses of territorial governance and sectors will provide bottom-up contribution to the Albania's EU integration process from a territorial development perspective. Furthermore, our intention is to catalyse a regional discourse on the complex, multi-level, polycentric and network-based mechanisms of territorial governance, still an 'abstract sounding' and difficult to comprehend and apply concept. Through this review, we aim to explain the concept of territorial governance and break it into implementable components for the Albanian institutions.

Wishing you a pleasant reading of our *'Annual Review of Territorial Governance in Albania'*, I take the opportunity to extend the invitation to all interested researchers and the wider body of experts and practitioners in Albania and the region, to view this periodical as a platform for sharing, and exchanging research-based know-how on territory and governance.

Sincerely,  
Rudina Toto  
Editor-in-Chief

Në kuadër të ambicieve aktuale socio-politike dhe dinamikave rajonale në Shqipëri si pjesë e Ballkanit Perëndimor, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Universiteti POLIS paraqesin numrin e parë të periodikut *'Qeverisja Territoriale në Shqipëri'*. Kjo është një platformë që ka për qëllim të çojë përpara kërkimet mbi qeverisjen territoriale në nivel kombëtar dhe rajonal duke bashkuar hulumtues dhe aktorë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët mund të ndikojnë politikëbërjen.

Ky publikim vjetor i kushtohet territorit për shkak të lidhjes së ngushtë të këtij të fundit me burimet, zhvillimin dhe rrjedhimisht qeverisjen. Artikujt fokusohen më së shumti në qeverisjen e ndjeshme ndaj territorit në Shqipëri por ofrojnë gjithashtu edhe analiza dhe vrojtime mbi ndërlidhjet mes kornizave dhe politikave territoriale kombëtare dhe atyre të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, me qëllimin për të përmirësuar qeverisjen territoriale vendore dhe për të ndikuar njëzëri te proceset e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE nga perspektiva e qeverisjes territoriale.

Ne përqendrohemi te qeverisja territoriale pikërisht për dimensionin e saj të ndjeshmërisë ndaj territorit. Kjo është një qeverisje që kujdeset për burimet, pavarësisht kufijve administrativë apo përfaqësimeve politike dhe, si e tillë, duhet zbatuar në çdo sektor, duke qenë se të gjithë sektorët varen nga burimet.

Edhe pse një fushë e rëndësishme, e cila vë theksin mbi rolin e territorit në politikëbërje, planifikimi është vetëm një nga format e qeverisjes territoriale. Suksesi i kësaj të fundit varet kryesisht nga koordinimi që arrin me sektorët e tjerë të zhvillimit dhe nga sinergjitë ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Kjo nënkupton ndërveprime dinamike ndërmjet palëve të interesuara (zyrtare dhe jozyrtare) në të gjitha nivelet institucionale dhe shkallët territoriale. Kësisoj, artikujt, siç do të zbuloni në vijim, trajtojnë një sërë sektorësh dhe ndërveprimesh në lidhje me territorin si dhe mënyra të ndryshme të qeverisjes policentrike dhe shumënivelëshe.

Çdo artikull është një dokument politikash i bazuar në hulumtime, informacione të mbledhura dhe analiza të ndërmarra nga autorët dhe pajis me rekomandime konkrete kryesisht institucionet shqiptare, ndërkohë që kontribuon edhe në reduktimin e hendekut informues mbi Shqipërinë në shkallë ndërkombëtare. Ne ushqejmë shpresën se analiza të tilla të qeverisjes territoriale dhe të sektorëve do të pajisin procesin e integritit evropian me kontribute nga 'poshtë-lart' për sa i përket zhvillimit territorial. Veç kësaj, ne synojmë të katalizojmë *diskursin* rajonal rreth mekanizmave kompleksë, shumënivelësh, policentrikë dhe të bazuar në rrjete bashkëpunimi të qeverisjes territoriale, e cila për momentin përbën një koncept abstrakt, të vështirë për t'u rrokur dhe zbatuar edhe në nivel Evropian. Nëpërmjet këtij botimi, ne përpiqemi të shtjellojmë konceptin e qeverisjes territoriale dhe ta zbërthejmë atë në komponentë të zbatueshëm për institucionet shqiptare.

Duke ju uruar një lexim të këndshëm të botimit *'Qeverisja Territoriale në Shqipëri'*, gjej rastin t'u parashtroj të gjithë kërkuesve shkencorë të interesuar si dhe trupit më të gjerë të ekspertëve dhe profesionistëve, në Shqipëri dhe rajon, ftesën për ta konsideruar këtë periodik si një platformë për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri teknike, të bazuara mbi kërkime për territorin dhe qeverisjen.

Singerisht,  
Rudina Toto  
Kryeredaktore

# Challenges of Regional Development in Albania

## Sfidat dhe rruga drejt zhvillimit rajonal në Shqipëri

Fiona Imami<sup>a</sup>, Anila Bejko (Gjika)<sup>b</sup>, Dritan Shutina<sup>c</sup>

### Summary

In practice, regional and territorial development is driven by various motivations and policy objectives. Being a context specific process, there is no 'one size fits all' process or method. Though approached differently in terms of territorial and institutional set-up, regional development is mainly used as an instrument to address issues of economic and social imbalances.

Affected by the difficulty of undertaking regional development reforms to balance domestic needs, policies prescribed by EU accession requirements, and a lack of capacity, regional development reform in Albania is hampered by the uncertainty and indecision of governments to undertake only a socio-economic development reform, or a governmental administrative reform as well.

The discussion of regional development has been on and off several times in the last sixteen years. There are still uncertainties about the choice between regional development policy (which aims to ensure the proper funding/resource allocation and priority setting for socio-economic development) and regionalisation (with the goal to decentralise/deconcentrate policy making and service provision to the regional level). Both policy options, in their essence, intend to improve the quality of life of citizens. As such, this paper argues that these policy options are not mutually exclusive. On the contrary, regional development policy, if implemented successfully, can pave the way for further decentralising/deconcentrating governance at regional level.

This paper first describes the processes that have taken place so far with regards to regional development and its policy implications. Considering the current state of development and the EU integration process, the paper argues for the need to complete and implement the on-going Regional Development Reform by focusing on two main directions: institutional set-up and resource allocation on the one hand, and the governance model on the other.

**Keywords:** Regional Development, Albania, EU Accession

### Contact | Kontakt

<sup>a</sup>fiona\_imami@co-plan.org (Corresponding author)

<sup>b</sup>anila\_gjika@co-plan.org

<sup>c</sup>dritan\_shutina@co-plan.org

Co-PLAN, Institute for Habitat Development, Permanent Workshop on Territorial Governance  
POLIS University, Tiranë, Shqipëri, [www.co-plan.org](http://www.co-plan.org); [www.universitetipolis.edu.al](http://www.universitetipolis.edu.al)



## Përmbledhje

Zhvillimi rajonal dhe ai territorial janë nxitur përgjithësisht nga qëllime dhe objektiva politike të ndryshme, të paktën siç dëshmohej nga praktika. Duke qenë një proces specifik për kontekstin në të cilin zbatohen këto reforma, nuk ekziston një formë, një metodologji apo një proces i paracaktuar për t'u adoptuar njëloj në çdo kontekst. Zhvillimi rajonal është instrumenti që adreson çështjet që lidhen me pabarazitë ekonomike dhe sociale të një vendi, ndonëse qasja për ta promovuar atë mund të jetë e ndryshme në territor apo strukturë institucionale.

Zhvillimi Rajonal në Shqipëri, si një proces kompleks reformash që balancon nevojat e brendshme, politikave të BE-së në kuadër të aderimit të pritshëm, dhe mungesën e kapaciteteve, ndër vite, është penguar nga pasiguria dhe paaftësia e qeverive për të vendosur nëse do të ndërmarrin vetëm reforma me fokus zhvillimin socio-ekonomik të vendit, apo edhe reforma administrative qeverisëse.

Ndërkohë që diskutimi për zhvillimin rajonal është rimarrë disa herë në gjashtëmbëdhjetë vitet e fundit, ende ka paqartësi në zgjedhjen midis Zhvillimit Rajonal (si një politikë që adreson nevojën për të siguruar shpërndarjen e duhur të burimeve dhe vendosjen e prioritetëve për zhvillimin socio-ekonomik në territor) dhe Rajonalizimit (decentralizimi/dekoncentrimi i mëtejshëm i vendimmarrjes dhe ofrimi i shërbimeve në nivel rajonal). Në thelb, të dyja janë opsione që synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës për qytetarët. Si të tilla, sikurse diskutohet në këtë artikull, këto opsione nuk janë reciprokisht përjashtuese. Përkundrazi, Zhvillimi Rajonal, nëse zbatohet me sukses, mund të hapë rrugën për decentralizimin/dekoncentrimin e mëtejshëm të qeverisjes në nivel rajonal.

Kështu, artikulli përshkruan së pari proceset që kanë ndodhur deri më tani në lidhje me Zhvillimin Rajonal dhe ndikimet e tyre në politikëbërje. Duke marrë parasysh situatën aktuale të zhvillimit dhe procesin e integritimit në BE, dokumenti argumenton nevojën për të përfunduar dhe zbatuar reformën e zhvillimit rajonal duke u fokusuar në dy drejtime kryesore: atë të ndërtimit të strukturave institucionale dhe ndarjes së burimeve nga njëra anë dhe atë të ngritjes së një modeli të ri qeverisjeje nga ana tjetër.

**Fjalë kyçe:** Zhvillimi rajonal, Shqipëria, integrimi në BE

## Regional Development and the Regionalisation Context to Date

So far, regional development in Albania has been closely linked to whether or not, and how to restructure the second level of local government in a way that improves coordination between national and local policies in support of socio-economic development and better services for citizens. However, this discussion has mostly taken place as part of decentralisation and territorial administrative reforms, and somehow the regionalisation aspect has been side-lined, considered as too much to take on or too complex. In turn, the *Qark*, conceived as second tier local

## Konteksti i zhvillimit rajonal dhe rajonalizimit në Shqipëri

Deri më tani, Zhvillimi Rajonal në Shqipëri ka qenë i lidhur ngushtë me 'Si?' dhe 'Nëse' është e nevojshme të ristrukturohet niveli i dytë i qeverisë, si një mënyrë për të përmirësuar koordinimin e politikave kombëtare me ato vendore, në mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët. Megjithatë, ky diskutim ka ndodhur gjithmonë si pjesë e procesit të decentralizimit dhe reformave administrative territoriale, ku aspekti i rajonalizimit është lënë mënjanë thujtë në secilin rast, duke u konsideruar si një hap shumë i madh për t'u



government institutions, neither became an effective level of local government nor turned into a regional government entity. As a result, efforts to undertake the Regional Development Reform were not able to produce concrete, sustainable outcomes.

The initial discussion on regions and regional development started in 2000 with the adoption of a decentralisation strategy and later, with a territorial administrative reform (2002), which both stipulated the role and functions of the first and second tiers of local government. While the role of the local government units (LGUs) (municipalities and communes before 2015) was somewhat clear, the approach of the stakeholders (both the central government and technical advisers) to the second tier of local government was to specify the role of the *Qark* at a later time, when the context would be more mature and the challenges of the first tier were addressed. Still, since 2000, *Qarks* have been positioned to play an important role<sup>1</sup> in coordinating the local development strategies drafted by the LGUs within their territories (at least by law).

The first effort for a comprehensive national strategy of regional development came in 2007, one year after Albania signed the Stabilization and Association Agreement (SAA) with the EU. In preparing the National Strategy for Development and Integration (NSDI) 2007- 2013, a number of cross-cutting strategies were prepared, one of which was the Regional Development Crosscutting Strategy (RDCS). However, the RDCS was never implemented because of the lack of institutional clarity; it did not have financial resources or a mechanism stipulating how regional development would be financed, and it was not aligned with the EU's mechanisms, principles, and approaches for regional development.

The more Albania was gearing up for EU candidacy, the more regional development as a tool for socio-economic development was gaining relevance from the perspective of accessing EU funds. From the EU's perspective, it is up to each country to organise its governmental levels and their respective roles and responsibilities. Yet, a clear institution set-up for regional development that ensures policy, programming, and an implementation process in line with the principles

trajtuar ose një proces tepër kompleks për situatën aktuale. Nga ana tjetër, Qarku, i konceptuar si institucion i nivelit të dytë të qeverisjes vendore, as nuk u bë një nivel efektiv i qeverisjes vendore dhe as u shndërrua në një qeveri rajonale. Si rezultat, të gjitha përpjekjet për të ndërmarrë reformën e Zhvillimit Rajonal nuk mundën të materializonin rezultate të qëndrueshme.

Diskutimi fillestar për rajonet dhe zhvillimin rajonal nis që nga viti 2000, me miratimin e Strategjisë së Decentralizimit dhe reformës administrative territoriale (2002), të cilat përcaktojnë të dyja rolin dhe funksionet e niveleve të para dhe të dyta të qeverisjes vendore. Ndërkohë që roli i NJQV-ve (bashkitë dhe komunat para 2015) ishte disi i qartë, qasja e qeverisë për nivelin e dytë të qeverisjes vendore, Qarkun, ishte ajo e specifikimit të rolit të tij në një moment të dytë, kur konteksti Shqiptar do të ishte më i pjekur dhe sfidat e nivelit të parë të qeverisjes do të ishin adresuar. Megjithatë, që nga viti 2000<sup>1</sup>, së paku me ligj, Qarku u pozicionua për të luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e strategjive zhvillimore vendore të hartuara nga NJQV-të e përfshira në territorin e tij.

Përpjekja e parë për një strategji gjithëpërfshirëse kombëtare të ZHR-së erdhi në vitin 2007, një vit pasi Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit (MSA) me BE-në. Me përgatitjen e 'Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim' (SKZHI) 2007-2013, u përgatitën edhe një sërë strategjish ndërsektoriale ndër të cilat edhe 'Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal' (SNZHR). Megjithatë SNZHR-ja nuk u zbatua kurrë për shkak të mungesës së qartësisë institucionale, mungesës së burimeve financiare ose të një mekanizmi që përcaktonte mënyrën se si do të financohej ZHR-ja dhe të mosqenit në linjë me mekanizmat/parimet/qasjet e BE-së për ZHR-në.

Nga ana tjetër, ndërkohë që Shqipëria po përgatitej gjithnjë e më shumë për kandidaturën drejt BE-së, Zhvillimi Rajonal, si mjet për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social në vend, po fitonte rëndësi gjithnjë e më të madhe nga perspektiva e përfuturit të fondeve të BE-së. Nga pikëpamja e BE-së, i takon vendit të vendosë mbi organizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Megjithatë, BE-ja parashikon një strukturë të

of multi-level governance and partnership is expected by the EU.

In 2010, regional development gained significant momentum in light of the progress Albania was making towards its candidacy for EU membership, entailing eligibility for the Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA), component III. With EU support, the Albanian Government prepared the first report on Chapter 22<sup>2</sup>, as well as the Regional Development Policy Framework 2010-2020. This policy, based mainly on EU cohesion policy, aimed to address regional disparities and establish regional development mechanisms compatible with the EU system. During this period, a decision on NUTS 2 was also made. However, this decision was made only to comply with Eurostat requirements and no consideration was given to regional development or how statistics should inform policymaking.

Since things did not go as expected (the country was not granted candidate status in 2010 or 2011), the government's interest in regional development waned, and the reform process was halted for some years.

In 2014, a newly elected Albanian government defined the decentralisation and regionalisation reforms as main priorities (PM, 2013). A Territorial Administrative Reform (TAR) was implemented, resulting in the consolidation of 373 municipalities and communes (urban and rural LGUs) into 61 municipalities. This was followed by the preparation of a new Decentralisation Strategy, aiming to give more power and autonomy to LGUs in Albania, and the preparation of a Law on Local Finances, which should further address fiscal decentralization towards them.

Meanwhile, the second tier of local government, the *Qark*, was left out of the reform process on purpose, considering the implications of revisions that would need to be addressed in the Albanian Constitution<sup>3</sup>, along with other political aspects related to the election system<sup>4</sup>. As such, regionalisation held the attention of the government, but because of the obstacles mentioned and the need to build consensus with the opposition, it was postponed for a later, more appropriate moment.

Yet, from the EU's perspective, the need to

qartë institucionale për zhvillimin rajonal që siguron procesin e politikëbërjes, programimit dhe zbatimin në përputhje me parimet e qeverisjes shumëpalëshe dhe qasjes së partneritetit.

Në vitin 2010, ZHR-ja fitoi një moment të rëndësishëm në dritën e progresit që Shqipëria po bënte drejt kandidimit për anëtarësim në BE duke u përfshirë në mundësinë për të aksesuar në komponentin IPA III.

Me mbështetjen e BE-së, qeveria shqiptare përgatiti raportin e parë mbi kapitullin 22<sup>2</sup> si dhe Kornizën e Politikave të Zhvillimit Rajonal 2010-2020. Kjo politikë, e bazuar kryesisht në përafrimin me politikën e kohezionit të BE-së, kishte për qëllim adresimin e pabarazive rajonale dhe krijimin e mekanizmave të ZHR-së në përputhje me sistemin e BE-së. Gjatë kësaj periudhe u ndërmor dhe një vendim për NUTS 2. Ky vendim, i marrë vetëm për të qenë në përputhje me kërkesat e Eurostat, nuk merrte parasysh/në konsideratë zhvillimin rajonal dhe si statistikën duhet të informojnë politikëbërjen në këtë nivel.

Duke qenë se gjerat nuk shkuan ashtu siç pritej, sepse vendit nuk iu dha statusi i kandidatit në të dyja vitet 2010 dhe 2011, interesi i qeverisë për ZHR-në ra dhe procesi i reformës në zhvillimin rajonal u ndal për disa vite.

Në vitin 2014, qeveria e sapozgjedhur shqiptare përcaktoi reformat e decentralizimit dhe rajonalizimit si prioritet kryesor (KM, 2013). Në 2014 nisi zbatimin Reforma Administrative Territoriale e cila rezultoi në bashkimin e 373 bashkive dhe komunave (njësive të vetëqeverisjes vendore urbane dhe rurale) në 61 bashki të konsoliduara. Kjo reformë u pasua nga përgatitja e një Strategjie të re të Decentralizimit, me qëllim dhënien e më shumë pushteti dhe autonomie njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, si dhe përgatitja e një Ligji për Financat Vendore, i cili adreson më tej decentralizimin fiskal për NJQV-të.

Ndërkohë, niveli i dytë i qeverisë lokale, Qarku, u la me qëllim jashtë procesit të reformës, për shkak të implikimeve të mundshme si në aspektin e rishikimeve që do të nevojitej të bëheshin në Kushtetutën e Shqipërisë<sup>3</sup>, ashtu edhe në aspekte të tjera politike që lidhen me sistemin e zgjedhjeve<sup>4</sup>. Kësisoj, rajonalizimi ende mbajti vëmendjen e Qeverisë por, për shkak të të gjitha

address development issues through regional development was re-emphasised and, in turn, regional reform was defined as a national objective.

In 2014, the Government of Albania (GoA) embarked on a reform to boost regional development and established a Regional Management Mechanism to promote concerted economic development. Consequently, four regional development areas (with no administrative competencies and different from NUTS 2 areas) were designated in 2015. Furthermore, in December 2015, a decision of the Council of Ministers on the institutional framework of regional development was approved. As a result, a National Agency for Regional Development (NARD), a Regional Economic Development Agency, and four Regional Development Agencies (RDAs) were established.

As such, the GoA made a choice (explicitly or implicitly) to separate regional development as a policy from regionalization, and pursue regional development reform in line with EU regulations and complying with Chapter 22 requirements.

However, in 2017, after winning the majority of seats in Parliament and confirming the second governing mandate, the Albanian government started a restructuring process for all the line ministries and deconcentrated agencies at the *Qark* level. The vision is to group and reorganise many of these agencies according to the territorial division of regional development areas. The Ministry of Agriculture has been the first to follow this approach, organising the 12 Regional Agricultural Directorates and other deconcentrated agencies previously operating at the *Qark* level into four Regional Agencies of Agricultural Extension. The Ministry of Health and Social Protection is following this approach as well and other line ministries are expected to follow suit.

In June 2018, the GoA repealed the Decision of the Council of Ministers (DCM) no. 961/2015 (on establishing regional development agencies and related regional development areas) through DCM no. 438/2018 'On the Transition of the Functions of the National Agency for Regional Development (AKZHR), the Regional Economic Development

pengesave të përmendura më sipër dhe nevojës për të ndërtuar konsensus me opozitën, u shty për një moment më të përshtatshëm.

Megjithatë, në perspektivën e BE-së, u theksua nevoja për të trajtuar çështjet e zhvillimit përmes Zhvillimit Rajonal, kështu reforma rajonale u përcaktua si një objektivi kombëtar.

Në vitin 2014, Qeveria Shqiptare ndërmori një reformë për të shtyrë më tej ZHR-në dhe zhvilloi një Mekanizëm të Menaxhimit Rajonal, duke synuar nxitjen e zhvillimit të përbashkët ekonomik. Rrjedhimisht, në vitin 2015 u përcaktuan 4 Zonat Rajonale të Zhvillimit (pa kompetenca administrative dhe të ndryshme nga ato të NUTS 2). Për më tepër, në dhjetor të vitit 2015 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave kuadri institucional i zhvillimit rajonal. Si rezultat, u krijua Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal, Agjencia Rajonale e Zhvillimit Ekonomik dhe 4 Agjenci të Zhvillimit Rajonal.

Kështu, në mënyrë eksplicite apo implicite, qeveria shqiptare zgjodhi ta ndante ZHR-në si politikë nga rajonalizimi dhe të ndiqte reformën e Zhvillimit Rajonal brenda perspektivës së BE-së dhe nevojës për të përmbushur kërkesat e Kapitullit 22.

Megjithatë, në vitin 2017, pasi fitoi shumicën e vendeve në Parlament dhe konfirmoi mandatin e dytë qeverisës, Qeveria Shqiptare filloi gjithashtu një proces ristrukturimi për të gjitha ministritë e linjës dhe agjencitë e dekoncentruara në nivel qarku. Vizioni në këtë rast ishte grupimi dhe riorganizimi i shumë prej këtyre agjencive sipas ndarjes territoriale të zonave të zhvillimit rajonal. Ministria e Bujqësisë ishte e para që ndoqi këtë qasje, duke organizuar 12 drejtoritë bujqësore rajonale dhe agjencitë e tjera të dekoncentruara që ushtronin më parë funksionet në nivel qarku, në katër Agjencitë Rajonale të Shtrirjes Bujqësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po ndjek gjithashtu këtë qasje ndërkohë që edhe ministritë e tjera të linjës pritet të ndjekin po të njejtën qasje.

Së fundmi, në Qershor të vitit 2018, Qeveria Shqiptare shfuqizoi VKM nr. 961/2015, 'Për krijimin e Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Zonave të Zhvillimit Rajonal', përmes VMK nr. 438/2018 'Për kalimin e funksioneve të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit

Agency (NARD) and the Regional Development Agencies (RDAs) to the Albanian Fund', which foresees the allocation of regional development related functions to the Albanian Development Fund<sup>5</sup>. It is not yet clear what is going to happen with the regional development areas or even the Regional Development Agencies (RDAs), as the latter are only legally defined in the repealed legal framework.

Though receiving a high priority from the GoA, the regional development reform is facing several challenges in its implementation – from a lack of a proper vision and focus of the reform, to missing clarifications for the implementation mechanism, institutional set up, and role of the different institutions in this process. On the other hand, regionalization (or the regional governance reform) is not a part of the policy discourse and does not have clear objectives or targets, but in practice, line ministries are restructuring their directorates along the four RDAs. So, while regional development is being pursued separately from regionalisation, *both* reforms are at a crossroads. In discussing them, concepts seem to be mixing and overlapping related to regional development, regionalization, and their governance aspects.

## Policy Gaps and Challenges for Regional Development in Albania

Formulating and implementing a comprehensive and coherent regional development policy is a complex issue. The Albanian political environment is characterized by vertical dependencies between levels of government, a lack of horizontal interaction, and coordination among stakeholders in multiple sectors, as well as a lack of partnership between public and private actors. Moreover, discussions regarding decentralisation/deconcentration (which includes regional development) have mainly been approached as a matter of institutional restructuring. So far, there have been very few considerations for the territorial development objectives to be achieved and the desired relationship between state and non-state stakeholders that ultimately foster to achieve those objectives.

Furthermore, while a full-fledged regional development reform would result in higher

Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe agjencive të zhvillimit rajonal (AZHR) te Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) i cili parashikon kalimin e funksioneve të zhvillimit rajonal tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit<sup>5</sup>. Situata mbetet ende e paqartë në lidhje me zonat e zhvillimit rajonal apo Agjencitë e Zhvillimit Rajonal, këto të fundit të përcaktuara ligjërisht vetëm në kuadrin ligjor tanimë të shfuqizuar.

Edhe pse duket se ka marrë përparësi të madhe nga Qeveria e Shqipërisë, reforma për Zhvillimit Rajonal po përballet me një sërë sfidash në zbatimin e saj, duke filluar me mungesën e një vizioni dhe fokusi të duhur/të qartë të reformës, mungesën e qartësisë mbi mekanizmin e zbatimit dhe strukturën institucionale dhe rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces. Nga ana tjetër, rajonalizimi ose reforma e qeverisjes rajonale nuk është pjesë e diskutimit të politikëbërjes me objektiva dhe synime të qarta, ndërkohë që, në praktikë, ministritë e linjës po ristrukturojnë drejtoritë e tyre përgjatë katër zonave të zhvillimit rajonal.

Kështu që, ndërkohë që duket se është bërë një ndarje në ndjekjen e ZHR-së si politikë veçmas nga procesi i rajonalizimit, të dyja reformat si të tilla mbeten në udhëkryq.

## Hendeqet dhe sfidat e politikëbërjes në lidhje me zhvillimin rajonal në Shqipëri

Formulimi dhe zbatimi i një politike gjithëpërfshirëse dhe koherente të Zhvillimit Rajonal është padyshim një çështje komplekse. Mjedisi politik shqiptar karakterizohet nga varësia vertikale midis niveleve të qeverisjes, mungesa e bashkëveprimit horizontal dhe koordinimit midis palëve të interesuara në sektorë të ndryshëm si dhe mungesa e partneritetit midis aktorëve publikë dhe privatë. Për më tepër, diskutimet mbi decentralizimin/dekoncentrimin e ZHR-së janë trajtuar kryesisht si ristrukturim institucional. Deri më tani, ka pasur pak konsiderata për objektivat që duhen arritur për zhvillimin territorial si dhe për marrëdhëniet e dëshiruara midis aktorëve qeveritarë-shtetërorë dhe atyre jo-shtetërorë, të cilat në fund të fundit nxisin arritjen e objektivave.

Për më tepër, ndërsa një reformë e plotë e Zhvillimit Rajonal besohet se do të rezultojë në shanse më



chances for the democratisation of governance, in Albania, *delephobia*<sup>6</sup> (as a new expression for the fear of delegating) seems to occur among policy actors at the national level. National authorities have often justified their tendency to shy away from devolution and delegation with the concern that local and regional authorities lack knowledge and experience in matters related to cohesion policy. This kind of attitude may sound reasonable but, in fact, it has a high probability of undermining decentralisation and poses serious obstacles to the implementation of the regional development policy and absorption capacity of managing EU funds.

Pike, Rodriguez-Pose and Tomaney (2006) states that successful bottom-up regional development approaches require a continuous shift of power from the central government to regional and local governments. Two key aspects should be considered in this regard:

1. Devolution – the process that involves the decentralisation of powers and responsibilities from the national to the sub-national scale (meaning here the initiative for regionalisation and creation of intermediate governmental bodies/institutions).
2. Governance – a new dimension, which involves an increasing emphasis on partnerships between governmental, quasi-governmental, and non-governmental (private and voluntary) organizations.

In the Albanian context, the choice has been made not to pursue a full-fledged decentralisation/regionalisation reform and to approach regional development as economic development and the reduction of regional disparities. However, as ESPON (2017) suggests, balanced territorial development is not about promoting massive investments for greater growth; it is about making use of existing resources for combined and balanced growth among territorial structures. As such, though Albania started by seeing regional development as socio-economic development, there will eventually be a need for government restructuring at the regional level and, above all, improved governance and interaction among stakeholders.

At this point it is important to emphasize that,

të larta për rritjen e demokratizimit të qeverisjes, në Shqipëri duket se po shfaqet ndjeshëm midis politikëbërësve në nivel kombëtar *delephobia*<sup>6</sup>.

Autoritetet kombëtare shpesh e justifikojnë tendencën për të qëndruar larg dekoncentrimin dhe delegimit me shqetësimin se autoritet vendore apo edhe ato rajonale nuk kanë njohuritë dhe përvojën e duhur në lidhje me politikën e kohezionit. Ky lloj qëndrimi mund të duket i arsyeshëm në fillim, por në fakt rrit probabilitetin për minimin e decentralizimit dhe padyshim përbën një pengesë serioze për zbatimin e politikës për zhvillimin rajonal dhe kapacitetin përthithës për menaxhimin e fondeve të BE-së.

Pike, Rodríguez-Pose, and Tomaney (2006) thekson se qasjet e suksesshme nga poshtë-lart të zhvillimit rajonal kërkojnë një zhvendosje të vazhdueshme të pushtetit nga qeveria qendrore në qeverisjen rajonale dhe vendore duke konsideruar dy aspekte kryesore në këtë drejtim:

1. Dekoncentrimin - që është procesi i cili përfshin kalimin e kompetencave dhe përgjegjësisë nga niveli kombëtar në shkallën nënkombëtare/vendore, duke nënkuptuar këtu iniciativat për rajonalizimin dhe krijimin e trupit/institucionit të ndërmjetëm qeveritar.
2. Qeverisjen - si një dimension i ri i cili përfshin një theks gjithnjë e më të madh tek partneriteti midis organizatave qeveritare, gjysmëqeveritare dhe joqeveritare (private dhe vullnetare).

Në kontekstin shqiptar, qartazi apo në mënyrë të nënkuptuar, është bërë një zgjedhje për të mos ndjekur një reformë tërësore të decentralizimit/rajonalizimit, por për t'iu qasur ZHR-së duke e trajtuar atë si zhvillim ekonomik për reduktimin e pabarazive rajonale.

Megjithatë, siç sugjeron ESPON (2017), zhvillimi i balancuar territorial nuk ka të bëjë me promovimin e investimeve masive për t'iu rritur më shumë, por me shfrytëzimin e burimeve ekzistuese për një rritje të kombinuar dhe të ekuilibruar midis strukturave të ndryshme territoriale. Në këtë kuadër, megjithëse Shqipëria ka filluar me ZHR-në si zhvillim socio-ekonomik, gjatë këtij procesi do të ketë nevojë për ristrukturimin e qeverisë në nivel rajonal dhe, mbi të gjitha, për përmirësimin e

while the government can choose how fast it wants to devolve power and how it wants to pursue regional development, the governance aspects are paramount for reform to be successful. In this case, regional governance would be considered a mechanism that allows for higher efficiency and equity in achieving regional development, rather than a means for redistributing power across the territory.

According to the EU Progress Report 2018, Albania is still only moderately prepared in the area of regional policy and two main pillars are still considered important to further comply with EU Cohesion Policy, such as:

- Addressing the lack of well-established regional structures and the capacity gaps within them;
- Accelerating the preparation of project documentation to avoid delays in the use of EU funds (EU, 2018).

